



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 12 datë 30/01/1998

**PER
KRIJIMIN E KESHILLIT TE KUJDESTARISE.**

Këshilli i Bashkisë së Tiranës, pasi mori në shqyrtim versionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, Albert Brojka, bashkë me Sekretarin e Këshillit Z.Përparim Bodinaku, vëren se :

Në bazë të kodit të familjes, neni.104 të tij, Këshilli i Bashkisë krijon Këshillin ose Organin e kujdestarisë të kësaj Bashkie. Meqënëse me zgjedhjet e Pushtetit Lokal të 20 Tetorit, u zgjodh Këshilli Bashkiak i ri ekzistues. Ky këshill duhet domosdoshmërisht të krijojë Organin e kujdestarisë me atributet që i cakton ligji.

Në këto kushte mbështetur dhe në zbatimin e nenit 104 të kodit të familjes dhe të nenit.14, të Ligjit Nr.7572, dt 10.06.1992 “Për organizimin e funksionimin e Pushtetit Lokal”

V E N D O S I

1. Të krijohet Organi (komisioni) i kujdestarisë i Bashkisë së Tiranës.
2. Ky organ të ketë 5(pesë) anëtarë me këtë përbërje :
 - Dy anëtarë të Këshillit Bashkiak, Z.Përparim Bodinaku dhe Znj.Nermin Basha.
 - Përgjegjësi i seksionit të arsimit
 - Drejtori i shëndetësisë dhe mjedisit
 - Një jurist

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak.

KRYETARI

ORHAN SAKIQI